

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"AMG Food" e skandalit të Salmonelës, pronare e kontejnerit me mish pule ku u gjetën 41 kg kokainë - R EPORT.AL
ADRESA	https://report.al/amg-food-e-skandalit-te-salmoneles-pronare-e-kontejnerit-me-mish-pule-ku-u-gjeten-41-kg-kokaine/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 17:34:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 16:50:33 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3b7e672c8136ecb85990b66a551110950528f2e61f7ff10057642c7898759788
TEKSTI	27990462caba7fef3a8beb476b4b030f855f9101c65913514505b1d6a60e9be3
PAMJA	293625f502065383511fe6b9a6d0227b0e1a4942cf886e72f65a2e8c22b47f58

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	93df0fd11c7e2a4348e5f12b291f5b8bcd707fcf70fa2b2321f63827a63c2177
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7d10e546d6131736d6471679d3f791247cbf6360c575f31a51d509cf567f1bfc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/93df0fd11c7e2a4348e5f12b291f5b8bcd707fcf70fa2b2321f63827a63c2177

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

[Home](#) [Aktualitet](#)

“AMG Food” e skandalit të Salmonelës, pronare e kontejnerit me mish pule ku u gjetën 41 kg kokainë

by **Bota Bota** — September 14, 2026 in Aktualitet, Kronikë, Kryesore0
SHARES[Share on Facebook](#)

 [Share on Twitter](#)

Detaje të reja kanë dalë në dritë nga **operacioni** i zhvilluar ditën e sotme në Portin e Durrësit, ku Policia sekuestroi **41 kg e 350 gramë kokainë**, me një vlerë tregu që përlogaritet rreth **2 milionë euro**.

Droga u zbulua në një **konteiner me origjinë nga Brazili**, i cili sipas dokumentacionit transportonte **mish pule**. Gjatë kontrollit, efektivët gjetën 37 paketime me lëndë të dyshuar narkotike kokainë të fshehura në kapakët e jashtëm të konteinerit.

Sipas **MCN**, kompania që kishte porositur ngarkesën e mishit të pulës, ku u gjetën edhe 41 kilogramët e kokainës, është **AMG Food**, me administrator/pronar **Arben Goxhaj**.

Kompania rezulton të jetë e lidhur me ngarkesën e kontrolluar nga autoritetet në Portin e Durrësit, ndërsa mbetet për t'u përcaktuar nga hetimi nëse porositisit e ngarkesës kanë pasur dijeni për lëndën narkotike të fshehur në kontejner.

Emri i **AMG Food** nuk është i panjohur për autoritetet shqiptare. Kompania ishte përfshirë edhe në një tjetër çështje të bujshme në mars të vitit 2025, kur një ngarkesë me mish pule të importuar nga Brazili **rezultoi e kontaminuar** me bakterin **Salmonella Typhimurium**.

Në atë rast, autoritetet ushqimore bllokuan një sasi të mishit, ndërsa sipas raportimeve, një pjesë e produktit kishte dalë në treg. Hetimi u zgjerua edhe ndaj personave përgjegjës për importimin dhe shpërndarjen e ngarkesës.

Në prill 2025, **Arben Goxha**, i lidhur me AMG Food, u ndalua pasi ishte shpallur në kërkim në lidhje me çështjen e mishit të pulës me salmonelë. Ai dhe persona të tjerë u hetuan në kuadër të këtij rasti.

Tashmë, më shumë se një vit pas këtij episodi, kompania del sërish në vëmendje të autoriteteve. Megjithatë, deri në këtë fazë nuk ka një të dhënë zyrtare që lidh kompaninë me trafikimin e kokainës.

Hetimet e Policisë dhe Prokurorisë pritet të përcaktojnë nëse porositësit e ngarkesës kishin dijeni për drogën e fshehur në kontejner.

Tags: [AMG FOOD](#) [Kokainë](#) [kontejner](#) [Porti i Durrësit](#)

TË FUNDIT

"AMG Food" e skandalit të Salmonelës, pronare e kontejnerit me mish pule ku u gjetën 41 kg kokainë

SEPTEMBER 14, 2026

**Do të... Universiteti
Ndërkombëtar i Mjekësisë në
Fier**

SEPTEMBER 14, 2026

Bojkotohet mësimi te "Qemal Stafa"/ Gjimnazistët thirrje Ramës: Jep dorëheqjen!

SEPTEMBER 14, 2026

**Lala: Rregullorja e GJKKO-së
cenon median, çështja mund të
shkojë në Strasburg**

SEPTEMBER 14, 2026

**Nafta drejt 230 lekë për litër,
qeveria rri duarkryq**

SEPTEMBER 14, 2026

**I dënuar me burg për vrasje,
ekstradohet nga Shqipëria në
Kosovë i kërkuari
ndërkombëtar**

SEPTEMBER 14, 2026

Thesari zhbllokon pagat e GJKKO-së, ja cilët magjistratë përfitojnë

SEPTEMBER 14, 2026

**Ish-deputeti Alban Xhelili
emërohet drejtor i Postës
Shqiptare në Durrës**

SEPTEMBER 14, 2026

Berisha: Ka tension mes Ramës dhe Ballukut, shkak arrestimi i Gys Agasit

SEPTEMBER 14, 2026

**Kapen mbi 41 kg kokainë në
Portin e Durrësit nga Brazili,
vlëra në treg 2 milionë euro**

SEPTEMBER 14, 2026

[Previous Post](#)

[illegible]



Bota Bota

report.al

REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencja dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT

E rëndë, elektrikisti që humbi jetën
gjatë punës në Belsh nuk kishte
asnjë mjet mbrojtës

01

0 SHARES



Parandalohet ngjarja e rëndë në Rrogozhinë,
arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-
vjeçarin

0 SHARES



Identifikohet shqiptari i vrarë në Itali/ E lidhën
dhe e ekzekutuan në makinë, automjetin më pas
e hodhën në lumë

0 SHARES